

FAKTE E HULUMTIME MBI LËVRIMIN E GJUHËS SHQIPE

Nga prof.ing av. Sazan **GURI***

PËRMBLEDHJE

Gjuha shqipe ka mbirë e para në hapësirën Euro-Mesdhetare, sepse shqipja nëse do ishte e re do kishte ose do ia kishin caktuar një datë fillimi. Ajo është aq e vjetër saqë historia e shkruar euro-mesdhetare, pa dashje, edhe e dallon edhe e vërteton se gjuha shqipe është më e vjetra, dhe meqenëse edhe gjuha trashëgohet, shqipja rilindi e plotë pas shekujve të Errësirës. Shqipja mund të zbërthejë shkrimet e shumta të lashta të skalitura mbi gurë e poçe, të tilla si, ato të mëtuarra së përfaqësojnë gjuhët “e lashta greke” apo të qytetërimit Shumer 4500-1900 p.e.s.U provua se emërtimet Nëfillimë (Nephilim, ang.), Pjellargë, Tokarë, Arbërës, Arbëreshë, Arbanas dhe Arvareshu janë shprehje fjalore në shqip. Të gjithë këta emra i përkasin popullit të fillimit.

***Fjalë kyçe-** Nephilim, Pjellargë, Tokarë, Arbërës, Arbëreshë, Arbanas, Arvareshu, popull i fillimit.*

HYRJE

Rrokja e parë është mision për shqiptarët dhe gjuhën shqipe. Çdo fjalë të krahasuar me kuptim në natyrë buron nga gjuha shqipe dhe për çudi në gjuhët e tjera e zbërthyer dhe e ndarë në rrokje nuk ka vlerë apo kuptim. Foljet në shqip janë shumë të lira. Ato marrin frymë thellë dhe përdoren si të kudondodhura, ku mjafton t'i ndërrosh një tingull, një zgjatje tingulli të zanores që tashmë kanë humbur në shqipen e sotme dhe ajo merr kuptim e rëndësi tjetër. Fjalët në fillimet njerëzore lindën dhe u formuan si rezultat i zhurmës apo gjurmës që ajo linte në natyrë dhe është lodhje, më saktë pak si ‘naivitet’ t'i shpjegosh ato me rregullat e sotme. Ç'nuk bëjnë të shkretët grekë e latinë për të bërë çdo gjë të tyren, dhe nga ana tjetër ç'nuk bëjnë shqiptarët për të zhbërë çdo gjë të tyren. Fjalët e shqipes janë jehona që veprimi i tyre lë në natyrë. Gjuha shqipe ua dha gjuhëve të tjera fjalët me një rrokje dhe ua mori prap ato, por me dy apo tri rrokje. Kur keni përpara ndonjë fjalë të huaj për të mësuar, mos harroni ta ndani atë në njërrokëshe, dhe me pak vëmendje do të gjeni fjalën përkatëse të gjuhës shqipe. Ajo që të shtyn të mendosh origjinën me bazë shqipe të këtyre fjalëve në gjuhët me bazë latine është se e shkëputur njërrokëshi i parë bazë që ndërton fjalën përbërëse nuk jeton më vete, ndërsa në shqip ajo kumbon, sepse shpreh matje, sasi, numra.

**Akademia e Shkencave "Rrënjët Tona", Studiuues i gjuhësisë në fushat albanologjike*

Rrokja e parë e një fjale evropiane është veçse shqip. Rastësi që perëndive iu del kuptimi i emrave nga shqipja. Rastësi që emrat e muajve të vitit iu del kuptimi nga shqipja. Rastësi që emrat e planetëve iu del kuptimi nga shqipja. Rastësi që fjalët shumere shkojnë cink për cink me fjalët shqipe. Rastësi që mbarten tek librat e shenjtë emra njerëzish qysh në kohën parakristiane në Shqipëri dhe Evropë që zbërthehen, jo rastësisht, me anë të shqipes. Rastësi që emra njerëzish në Greqinë e sotme dhe Evropë që zbërthehen, jo rastësisht, me anë të shqipes. Rastësi që kemi toponime konkrete me emrat mal, gur e pyll. Rastësi që me konceptin gur janë ndërtuar me mijëra toponime pikërisht në aq pjesë të kontinentit sa ata ishin shtrirë. Edhe me konceptin pyll janë ndërtuar shumë e shumë toponime në ato pjesë të kontinentit sa ishin shtrirë pellazgët.

I. FAKTE E HULUMTIME MBI LËVRIMIN E GJUHËS SHQIPE NË PERIUDHËN 2020 – 1920


1.1 Ky Kuvend me punimet dhe hulumtimet e tij gjuhësore do të sjellë kumtesa që të hedhin dritë mbi etimologjinë e gjuhës shqipe, duke sjellë në vëmendje fakte që kërkojnë përgjigje si:

1. ato që thotë i madhi Çabej, se nuk dimë çfarë kjo gjuhë iu ka dhënë gjuhëve të tjera;
2. ato që na la fjalori etimologjik i Gustav Mayer-it, ku në 5000 fjalë të gjuhës shqipe, dhuratë prej ‘atit’ të kësaj gjuhe K. Kristoforidhit, 4’300 prej tyre, ua gjente vendin, me zor apo pa zor, të lidhur me fjalë të sllavishtes së vjetër kishtare, ose latine, ose turke, dhe rallë herë të ardhur nga gjuha indiane. Por, i mbetën 780 fjalë dhe as me zor nuk ja u gjente dot prejardhjen në gjuhët e shpërmendura;
3. moria e fjalëve që bashkëlidhen si gjuhë mëmë me gjuhët e tjera të njerëzimit sipas një të madhi tjetër jo publik si P. Zheji, që shqipen e zbërthen deri në nivelet e valës kuantike dhe tregon se: *të gjitha gjuhët (të folmet) e botës i “falten” shqipes*, apo e thënë ndryshe, lidhen me të sikurse bijat dhe mbesat e stërmbesat e Shqipes si “Gjuhë mëmë”;
4. etimologjinë e shumë morfemave embrion të shqipes që syresh të caktuar e rendisin formimin e fjalës, sikur e përbëra prodhon të thjeshtë, që është e kundërta e thjeshta apo morfema prodhon të përbërën ose fjalën. A mundet që fjala *krie* të burojë nga ajo latine - *c(e)rebrum* ose ajo rumune “*crier*” për (tru), apo *prin* nga *primus*, *principal*, apo *tav* nga *tavola*, *tavolinë*, apo *lë* nga *laschare* apo *vjet* nga *veterano*, apo *dardan* nga *dardha*, ku brenda tyre rrinë për mrekulli njërrrokshet e gjuhës shqipe, si *kre*, *pri*, *tav*, *lë*, *vjet* dhe *da*?!. por, jo vetëm etimologjia e fjalëve, edhe veçoritë strukturore të shqipes - për sa kohë ato nuk

mund të shpjegohen si ndikime nga turqishtja, sllavishtja, gjuhët romane apo greqishtja - bazohen pa problem në dinamikën e brendshme të kësaj gjuhe.

1.2 Ky Kuvend me punimet e tij do të jetë i aftë:

1. të tregojë lidhjen gjuhësore të fjalës në gjuhën shqipe, me kuptimin e saj;
2. dhe sesi fjalët shqipe janë në gjendje të bëjnë vijën e ndarjes që dallon një gjuhë nga një tjetër.
3. të vërtetojë atë që thotë prof. Gjovalin Shkurtaj se “sintaksa e kësaj gjuhe është kështjellë e pamposhtur e gjuhës shqipe”.
4. të përshkruajë, pse gjuha shqipe, edhe pse e varfëruar nga një mungesë lëvrimi shumë shekullor shpreh’ me një ndjesi të mrekullueshme ngjyrimet, ku të folmet e ‘pështira’ ndonjëherë të librave të huaj i kthen në koncepte nga më të holla të mendjes njerëzore, ku rrok edhe dridhjet më të pakapshme të nervozizmit, dhe timbrin e fundit të dashurisë.
5. pse jo, dhe të rigjejë e të risjellë fjalët e humbura të gegënishtes që të ndjehet shqipeja e ‘Lahutës së Malësisë’ së Homerit shqiptar Gj. Fishta, dëshirë e munguar apo e plotësuar, me fjalorin e fjalëve të humbura të gegënishtes të studiuesit M.Elezi.
6. pse jo, të diskutojë dhe të pasurojë kërkesat në nevojë të gjuhës shqipe për rifutjen në normë edhe trajtën e infinitivit: *me qenë, me pasë, me bë, me shku, me punu, me lexu*, etj., si trajta të gjalla nga jugu në veri, në më shumë se 80% të territorit të kombit, ndërkohë që bëhet ‘nami’ për heqjen e një ë-je fundore dhe të ë-ve në mes të fjalëve, të cilat theksi i shqipes i ka zhdukur me kohë, apo rikthimin e apostrofit (m’jep, t’jap, m’bëj, t’bëj), i cili aq masivisht përdoret sot në gjuhën e folur. Pikërisht atë që Çabej i madh prapë thoshte se:



Alfabeti i Koriliano, i vitit 1895

Lista e 25 pjesmarrësve në Kongresin Gjuhësor Shqiptar, i mbajtur më 1 tetor 1895 në Koriliano (Corigliano Calabria), Provinca e Kozencës – Itali.

Fig. – 1 Alfabeti i Korilianos, v.1895; Lista e 25 pjesmarrësve në Kongresin Gjuhësor Shqiptar, v.1895, sipas studjuesit L. ALIAJ.

si standard i gjuhës sonë duhet vënë gjuha e gjallë që flet shumica e popullit, përndryshe do të bëjmë një gjuhë letre, e cila do të vdesë, sepse nuk do të flasë njeri.

7. Të diskutojë dhe të përkujtojë veprimtarive të shumta e të rëndësishme, siç janë edhe kongreset e patriotëve arbëreshë, që miratuan alfabetin shqip me germa latine dhe kontributi i patriotëve shqiptarë, që organizuan Kongresin e Manastirit, që miratoi alfabetin që kemi aktualisht, të cilët më 1 – 3 tetor 1895, pra 125 vjet më parë, zhvilloi punimet Kongresi i parë gjuhësor shqiptar në Koriliano Kalabro të Provincës së Kozencës¹, një ngjarje e rëndësishme e pasqyruar gjërësisht në shtypin italian dhe europian të kohës. Tema e këtij kongresi ishte prezantimi i aspekteve gramatikore, leksikore dhe fonetike të gjuhës shqipe, të asaj gjuhe të lashtë, të ëmbël e melodioze, që arbëreshët e ruanin dhe e kultivonin me dashuri dhe patriotizëm shembullor.

II. FAKTE E HULUMTIME MBI LËVRIMIN E GJUHËS SHQIPE NË PERIU DHËN 1920 - 1300

¹ Dr. Lutfi Alia <https://www.voal.ch/kongresi-gjuhesuer-shqiptarvitit-1895-ne-koriliano-itali-nga-lutfi-alia/>

2.1 Ky Kuvend me punimet e tij do të sjellë fakte e hulumtime shkencore mbi fillesat e qëndrimeve deri në arsyetime të plota të studiuesve, filologëve apo filozofët evropianë si:

1. G.V.Lajbnic, ku shkruan se: *shqipja është gjuha e ilirëve të lashtë...*²

2. Lejbniht që nuk përtonte të theksonte fort se: *gjuha shqipe ishte gjuhë themelore e kontinentit, gjuhë e ilirëve të vjetër.*

3. Marin Soresku që me plot gojë thoshte se: *shqipja është dëshmi e gjallë e qytetërimit të lashtë evropian*³

4. të studiuesit August Friedrich Pott, që *gjuhën shqipe e identifikonte me atë pellazgo-ilire*,⁴

5. deri te urtësia e gjuhëtarit August Scheicher, që konkludonte se: *gjuha shqipe është pellazgjishtja e vjetër*,⁵

6. mbi të gjitha, studiuesit e shekullit të kaluar, të cilët u mbështetën në ato që lanë amanet gjuhëtarët e shquar evropianë, si Pedersenin që porosiste se: *gjuha shqipe rrjedh nga gjuha e pararendësve të saj indoevropianë e ilirë*,⁶ aq më tepër dhe ky përcaktim i sajuar indoevropian kërkon një diskutim më vete.

7. Maurico Druon, anëtar i Akademisë Frënge, që me studimet e veta përfundonte se: *shqiptarët i përkasin popujve më të vjetër se vet' historia*; dhe se gjyshërit e shqiptarëve merrnin pjesë në luftën e Trojës, të udhëhequr nga Akili ...në njërin anë dhe Hektori në anën tjetër.

2.2 Ka ardhur koha që ndoshta ky Kuvend (dhe të tjerë pas tij), me punimet e tyre të nxjerrin në dritë veprat e plota të studiuesve shqiptarë si:

1. të Andrea Bogdanit (1683) që kishte shkruar një gramatikë latinisht e shqip, që sipas F. Bardhit ishte ‘nji gramatikë fort të godiçime latin e shqip’,

2. të Don Pjetër Budit prej Gurit të Bardhë për një botim të shtypur në gjuhën amtare⁶ në vjeshtën e v.1621

3. të Imzot P.Bogdanit, me bibliotekën e vet, që me anë të dy letrave të panjohura i drejtohet Kardinalit Kaponi, Prefekt i Kongregatës, që t’i dërgojë disa libra të

² G.V.Lajbnic, Letër revistës rumune “Albania”, më 10 dhjetor

³ Marin SORESKU, Poems chosen – Antology for school use, v.2006

⁴ August FRIEDRICH POTT, Etymologische researches in the field of Indo-European languages Lemgo 1833.


⁵ August SCHEICHER, A compendium of the comparative grammar of the Indo-European, Sanskrit, Greek, and latin languages,⁶ PEDERSENI, sipas veprës së Jakov MilAJ, Raca shqiptare, fq. 56, v.

⁶ shkroi revista Leka në numrin e datës 7 korik 1930.

vlefshëm, si: Doctrina Albanese 5 kopje, Dictionarij Albanesi 4 kopje, Gramatiche Illiriche 5 kopje, etj.

4. fjalorin DICTIONARIVM/LATINO EPIROTICVM më 1635, ku gjuha dhe lënda shqipe ndeshet me rreth 5 mijë fjalë latine të përkthyer në shqip.
5. të priftit arbëresh Lekë Matrenga, ku më 1592 botoi tre dorëshkrimet e shqipëruara të katekizmit “*E mbesuame e krishterë...*”
6. të Dh. Frëngut në veprën mbi Skënderbeun gjejmë një fjali të shkurtër shqipe⁷ si atë: “*Embetha*”, “*E mbë ta!*”

Fig. – 2 Formula e pagëzimit të Pal Engjëllit, në gjuhën shqipe.



7. të Pal Engjëllit, ku në midis latinishtes së kohës gjendet *formula shqip e pagëzimit*, që tregon se kleriku Pal e ka gjetur të shkruar këtë gjuhë, këtë alfabet, jo se e shpiku për hatër të kësaj fjalie pagëzimi. Ja që kemi një artefakt më të vjetër se Meshari, (1468) për të dhënë të paktën një datë tjetër historike të rilindjes, dhe jo të lindjes së gjuhës shqipe;
8. të humanistit të shquar Marin Barleti, në veprën e tij “*De obsi dione scodrensi*” (Mbi rrethimin shkodran), botuar në Venedik, më 1504, duke folur për qytetin e Shkodrës, bën fjalë: për fragmente të shkruara in “*vernacula lingua*“, d.m.th. në gjuhën e vendit, të cilat flasin për rindërtimin e qytetit të Shkodrës;⁸
9. të dy profesorëve austriakë që paraqesin fletën e një libri të Biblës që dokumenton gjuhën shqipe të shkruar në fillim të shekullit të XIV, ku na duhet të vërtetohet origjinaliteti i këtij dokumenti, që bëhet fjalë për shqipe të shkruar rreth shek.-XIV. Në foto - fleta e shkruar në italisht e në shqip: *Scala I. Ligierata VI*“;
10. nga më të vjetrin shkrim shqip të vitit 1167, i zbuluar nga historiani Nicolae Jorga në dorëshkrimet e Bibliotekës “*Laurentiana*”⁹;

⁷ v.1539, në fl.40b,

⁸ Dh. SHUTERIQI, Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879 – 1800, Fq.88, v. 2005.

⁹ Në *Firence, Ashburnham 1167 Laurentiana, Hasan Aliaj*
“*Rrenjet*” Nr. 17. 2019



Fig. – 3 Fletë e një libri të Biblës ku dokumentohet gjuha shqipe në fillim të shekullit të XIV.

Se përndryshe do të pranojmë atë që na thot me përbuzje kronisti turk E. Celebi më 1511, se shqiptarët nuk kanë shkrim të zhvilluar, kështu që edhe sikur të bëheshin myslimanë, si të tillë nuk do të ishin me vlerë dhe nuk do të bëheshin më të mirë.¹⁰

2.3 Ka ardhur koha që ndoshta ky Kuvend (dhe të tjerë pas tij), me punimet e tyre të hedhin dritë mbi kuvendet e organizuara për mëvetësinë, gjuhën dhe bibliotekat shqipe, pikërisht sesi:

1.mund të korrigohet marrëzia kolektive e 1946, që diktatura nxorri të gjitha librat me karakter albanologjik, historik e gjithfarësh në breg të Liqenit të Shkodrës, ku nuk shkuan drejt Serbisë për karton, por mbas një përzgjedhje të kujdesshme *pasunuen bibliotekat e Jugosllavisë, tue çveshë Shkodrën e Shqipnisë;*¹¹

2.mund të rivendoset dinjiteti me librat e shqipes, me *tradi tën e librit, sikundër thot* albanologu kroat Aleksandër Stipçeviç se: *në Shkodër është shumë e*

¹⁰ RUHI ÇELEBI EDRENEVIU, sipas Dhimitër Shuteriqit, Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800, fq. 99, v.2005

¹¹ shprehet historianeja Çapaliku

*hershme, madje fillesat e saj i gjen qysh në periudhën ilire dhe shënon se në Iliri ka pasur 72 biblioteka;*¹²

3.mund të rehabilitohen bibliotekat dhe arkivat e Lef Nosit, e Mithad Bej Frashërit, (me 18,000 kopje librash), e Eqrem bej Vlorës, etj., por mbi të gjitha biblioteka dhe arkivi i Etënve Françeskan dhe i atyre Jezuit në Shkodër;

4.të lexohet e të thuhet qart fraza greqisht-shqip-arumanisht-latinisht mbi një gravurë të Manastirit të Sh. Mërisë së Ardenicës, Lushnjë nga NEKTAR TERPO më1731, *Bylinj e Marieéπε ρήι*¹³ *Virgjin e mame e perëndisë uro për nee faj toretë – Virgjin, Mamë e perëndis, uro për në fajtoret;*

5.mund të thuhet fort që gjuha shqipe, edhe pse e ndaluar me ferman (1778), ajo vringëllonte po aq fort nënzhëshëm, siç na lë të shkruajtur shprehjen shqipe më 1785, prifti d'ERASMO DA BAGNO, kur dëgjoji nga Ali Pashai të thotë: *“iscalla kemi mar Venedikut gni arac fort’ i mir”;*

6.mund të gjenden fotokopje që ruhet në Institutin e Historisë të një vjershë shqip të një studenti shqiptar në Romë¹⁴,

7.mund të jenë pjesë e diturisë qytetare e shkollore ilahitë apo vjershat fetare të Mulla BEQIRIT, në shek. XVIII, ku na lë shprehje si: *“Shka osht kshtu, qi je habit”;*

8.të kujtojmë edhe hartimin e gjashtë alfabeve, duke përfshirë dhe atë të vithkuqarit Naum Veqilharxhi;

9.të thuhet fort që Kuvendi i Arbërit i mbajtur në fshatin Mërqi, rreth 3km në Veri të Lezhës, në kishën e Shën Gjonit, më 1706 CONCIËI / PROVINTTIAËI / O / CUVENDI I ARBENIT na lë shprehjen shqipe: *Mbeleiune nde viett gnni mije / sctat cint e tre. / NDENE CLEMENTIT / I GNIMIËTMI / PAPE PRETEMAËIT.*

10. lexohet fort parathënia e librit të De Leeces, kur i drejtohet Atit të Shenjtë në shqip me fjalët: *Arbënuer i dashtun, këtë gramatikë e shkrova, jo për zotërinë tënde që di më mirë dhe më kthjellët se unë, por për ata fratinët që vijnë prej së largu me shërby, ku është përdorur për herë të parë termi “shqiptar” në kuptimin etnik, në shprehjen “gjuha e shqiptarëve”;*¹⁵

Ja pse duhet të sillet si domethënie fakti se brenda një periudhe 50-60 vjeçare, 1770-1827, nga Kavalioti e deri tek Grigor Gjirokastriti, letërsia jonë është pasuruar me më

¹² Vepra madhore “Historia e librit”

¹³ Dhimitër SHUTERIQI, Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879 – 1800, Fq.-249, v. 2005

¹⁴ dëshmi e lënë nga i mirënjohuri JOHANN VOLFGANG VON

GOETHE, më 1787 na ka lënë dëshmi

¹⁵ Stefanaq POLLO, Probleme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Revista Pedagogjike.

shumë shkrime, se sa kanë qenë shkruar brënda 377 vjetëve që nga koha e Skënderbeut.

2.4 Ka ardhur koha që ndoshta ky Kuvend (dhe të tjerë pas tij), me punimet e tyre të hedhin dritë mbi fjalorët shqip, pikërisht sesi:

- 1.mund të gjendet dorëshkrimi “Fjalor Etimologjik i gjuhës shqipe” i N.Joklit, i humbur prej librave dhe bibliotekave;
- 2.mund të gjendet fjalori etimologjik i gjuhës shqipe i Mustafa Krujës;
- 3.mund të jenë pjesë e diturisë qytetare e shkollore episodet historike që i mirënjohuri Efstrat Vithkuqari, i dha në Janinë mësimet e gjuhës shqipe kolonelit anglez Lik (Leake), e më pas bashkëpunuan për një fjalor shqip-anglisht-greqisht, mbështetur në veprën e Dhanil Haxhi Voskopojarit me një gramatikë shqipe të botuar më 1814;
- 4.mund të jenë pjesë e diturisë qytetare e shkollore fjalori shqip i Theodor Kavaliotit¹⁶, që më pas e përdori Thumani, Martin Leake, që si jetoi për 10 vjet në tokën shqiptare, njohu gjuhën shqipe dhe shkruajti një gramatikë, si dhe fjalorin e gjuhës shqipe, me përkthimin në anglisht dhe në greqishten e re, duke shtuar numrin e fjalëve të gjuhës shqipe në 2100.¹⁷ Leake anonte nga mendimi i Thumanit dhe Malte Brunit se i njeh shqipëtarët si: *Illirët e vjetër* dhe forcon më shumë themelet e para të kësaj lavdie në filologjinë shqipe, dhe sigurisht merr në shqyrtim dhe paragjykimet e Bizantinëve;
- 5.bota e qytetëruar të njihet me modën e fjalorëve të gjuhës shqipe, si me glosarin e Kavaliotit (greqishtvllahisht-shqip), botuar në Venedik më 1770, dhe me fjalorin e Dhanilit të Voskopojes (greqisht-vllahishtbullgarisht-shqip), më 1802, dëshmi për të na dëftyer se gjuha shqipe nuk ka qenë vetëm e folur, por edhe e shkruar, madje edhe e krahasuar;
- 6.mund të jenë pjesë e diturisë qytetare e shkollore fjalë e shprehje të fjalorit të Kodikut Beratas si: njëmënit (tani), të paudhmetë (të këqijat), të perënduarit (perëndimi), të ngrehurat (krijesat), xhdo (çdo), ishtë, ishjam, buzë të ngazëlluame, ngazëllonem, lavduron, të luturit (lutja);
- 7.mund të jenë pjesë e diturisë qytetare e shkollore kodiku tjetër i Beratit që mbante lëndë mësimore fetare, ku në fq.77, lexojmë shqip, me alfabetin grek: “*këju (!) apostoll është i Shën Sotirit*”, shkruar më 23. VIII. 1764, d.m.th. më 3. VIII. Në faqen 75-76 është një fjalorth greqisht-shqip me 110 fjalë dhe në faqen 87-102, një fjalor tjetër greqisht-shqip me 1600 fjalë;

¹⁶ Bashkë me Kostë Beratin, Kavalioti zë vend të nderuar ndër shkrimtarët e vjetër të Toskërisë. Kavalioti e shkruan shqipen më me kujdes e korrektësi, sipas Stilian ADHAMI, Voskopoja dhe monumentet e saj, fq. 103, v.1998

¹⁷ Martin LEAKE “Researches in Greece”, Londër 1814.

8. bëhet me dije që më 1764, Kostë Cepi kishte kryer përkthime të ndryshme kishtare në gjuhën shqipe, si dhe dy fjalorë greqishtshqip, ku me vështirësi lexojmë: “*Perëndi liumea shpresë e gjithë të kështerëve ruaj e shpëto ata që shprejnë mbë ty*”, pra gjuha shqipe gëlohej e shkruhej;

9. shënohet v.1760, kohë e mësimit të gjuhës shqipe në shkollat greke në zonën e Vithkuqit, ku një tjetër Vithkuqar si Kostë Cepi, kishte kopjuar rreth vitit 1820 shkrimet dygjuhëshe, greqisht e shqip, të Kostë Beratit, që shërbenin për mësimin e greqishtes në shkollë, pra gjuha shqipe gëlohej e shkruhej;



Fig. – 4 Kopertina e fjalorit Kodiku Beratas

10. mund të jenë pjesë e diturisë qytetare e shkollore që gjuha shqipe përcillej edhe me anë të divanëve qysh para 1760, ku Nezim Ibrahim FRAKULLA, shkruan: *Këtë divan e zura shqip / ishalla na vjen për tertip!*¹⁸

11. të thuhet sërish fort përpjekja për të mbajtur gjallë gjuhën shqipe, me ‘Fjalorin italisht-shqip të DIEGO DA DESIO, më 1710, njëherësh edhe gramatikë, “Dizionario italiano & albanese”, me 957 fjalë italishte që shpjegohen shqip;

12. të zbulohet përkthimi i “Doktrinës së krishterë” të Neofrito RODINÒ dhe PAPA DHIMITËR DERVINA në Himarë (1637), që e mbajti gjallë këtë popull deri më vitin 1693, kur në bregdetin shqiptar vjen baziliani italian arbëresh Nilo Catalano që harton edhe një fjalor shqip-italisht e italisht-shqip;

13. të zbulohet i pari fjalor *LATINISHTSHQIP*”, i F.Bardhit (v.1635), ku zë fill shkencë gjuhësore shqiptare, përpos një fjalori tjetër Latin - Ep

¹⁸ Po aty, fq.280

Dictionarium Latino-Epiroticum

Civitas Urbium, quae in haec usque nobilissima, de naturali praesidentia exercitatae. Patria ac locus ex quo exiit
maximissima, matricumque ille Turcorum terror Georgius Castrioti Epiroticum gentis Princeps educebat. omnino et
potentia bellorum Alypuzi, neriye Pirihi Epiroticorum Regis) appellatus Turcice Sandjakli, id est Alexander
nomen in Dey, ac etiam Epiroticè è matricibus Castriotis et Alypuzi, id est Epita Duce, etc. Civitas, quae in Feroz) p.
Tuz) usque Epita usque Castriotis et Alypuzi debeat Epita, etc. Castriotis Epita, etc. Epita Castriotis Epita, etc. Epita Castriotis Epita, etc.
usque Epita et Castriotis Epita, etc. Castriotis Epita, etc. Epita Castriotis Epita, etc. Epita Castriotis Epita, etc.
Epita Castriotis Epita, etc. Epita Castriotis Epita, etc. Epita Castriotis Epita, etc. Epita Castriotis Epita, etc.

TITUS

Author: Blanch.

Franciscus Blanchus

Text: Diet

Dictionarium Latino-Epiroticum

On the basis of the original edition

Dictionarium Latino-Epiroticum,
per R.D. Franciscum Blanchum,

Romae: Typis Sac. Congr. de Propag. Fidei. 1635

Line 12	Eleusiosus Lernoscena	Line 21	Ager Basine
Line 13	Emerc Me bleem	Line 24	Agnis Ching
Line 14	Emsuere Melesuenduzae	Line 28	Agricola Panotuer
Line 15	Emutgere issan Me fryym humleae	Line 29	Agram colere Destinere me panem
Line 16	Enim, percioche Prasta	Line 37	Ala Fize
Line 17	Ens Catice	Line 38	Alapa Sceptaca
Line 18	Eraia Scpata	Line 39	Albania <u>Arbeni</u>
Line 19	Fa tempore Nitate Mos	Line 40	Albus luce
Line 20	Epirus <u>Arbeni</u>	Line 61	Alexander Alexandri
Line 21	Episcopus Ureschep	Line 62	Alibi Ngotai
Line 22	Epistola Lettere	Line 63	Alucrus inimicos Candra uscnieliz
Line 23	<u>Epirote</u> Iarbensee, Turcicè Armautlar	Line 64	Aut ego, aut tu - oò à, oò à)
Line 24	Equa, caualia Petia		

iroççe.

Përderisa ekzistokan fjalor, a nuk do të thotë se gjuha epire (çamçe sot), me patjetër edhe gjuha ilire kanë ekzistuar, më sakt kanë mbretëruar?

2.5 Ka ardhur koha që ndoshta ky Kuvend (dhe të tjerë pas tij), me punimet e tyre të hedhin dritë mbi shkollat shqipe, pikërisht sesi:

1. ndriçohet alfabeti pellazgjik i mjeshtri Teodor (Dhaskal Tod'hril), i këtij njeri të pathyeshëm, që iku në Venecia për të sjellë arka me shkronja floriri e kaluar floririt, arka për të cilat u vra, ndërsa arkat u plaçkitën.

Fig. – 5Fjalori i parë Latinisht- Shqip, i F.Bardhit (v.1635).



Fig. – 6 Alfabeti Pellazgjik i Dhaskal Tod'hrit

2. të thuhet fort që shqiptarët kanë pasur shkollë shqipe, si ajo më 1703 në Lezhë për të cilën flitet në aktet e Kuvendit të Arbërit, të botuara më 1706 në Romë,

3. të thuhet fort që shqiptarët në vitet 1705 –11, zhvillonin mësimin e gjuhës shqipe në Kuvendin S. Bartolemeo all'Isola, Romë, që jepej nga Francesco Maria da Lecce;

4. të ngrihen mbi rrënojat sot të shkollës së parë shqipe Gallat – Kurbin, me themelimit në 1632, shkolla muze për të, (foto djathtas), si dhe të rehabilitohet ish Selia Ipeshkëvnore e Durrësit me qendër në Delbnisht, njëherësh edhe shkolla shqipe e v.1856¹⁹, (foto majtas);

5. të kujtohen dhe të shkruhet me përkushtime të veçanta për shkollat me predikim shqip në Kelmend, Hot, Grudë dhe Kuç, (1636), ku mësohej shqipeja, me anë të gramatikës së *Andrea Bogdanit*;

6. të kujtohen dhe të shkruhet me përkushtime të veçanta për shkollat shqipe fillore e të mesme në Pëdhanë (Pllanë) të Lezhës që vazdonin të lulëzonin në periudhën 1638-1704, ndërkohë që misionarët italianë, të cilët u vendosën në Zadrimë e Blinisht më 1634, nisën shpejt ta mësonin gjuhën e vendit, jo thjesht për të folur, por në të shkruajtur në mënyrë që të mësonin të tjerët; Ndaj kemi shkollë fillore në Blinisht të Lezhës më 1639-48, që shpejt u bë edhe e mesme;

¹⁹ Mirënjohje Revistës Kurbini.



Fig. – 7 Ish selia e Ipeshkëvnore e Durrësit dhe njëherësh shkolla Shqipe, v.1856; Shkolla e parë Shqipe, Gallat-Kurbin, themeluar në vitin 1632.

7. të kujtohen dhe të shkruhet me përkushtime të veçanta për shkollat në Himarë, që dëshmon studiuesi dhe historiani Zassi se atë e ndiqnin “shumë të rinj shqiptarë”, pra, edhe nga fshatrat përreth, kështu që me ta puna nuk mund të bëhej pa ndihmën e gjuhës shqipe;²⁰

Ja pse duhet të lëçitet Vatikani e Stambolli nga studiuesit tanë, ku deri më sot, as 1% e volumit të veprave të tyre mbi shqipen dhe shqiptarët nuk janë prekur e studiuar? Ja pse, toka shqiptare nuk lejohej të gërmohej nën 60cm, sepse siç thoshte Haki Pasha: Po doli në shesh historia e shqiptarëve, Perandorinë Osmane e merr lumi". Jo më kot, Lamartini, gati gati bërtiste se:

*Ky komb e ky popull nuk duhet të merret nëpër këmbë... Kjo është toka e heronjve të të gjithë kohërave... Homeri aty gjeti Akilin, Grekët Aleksandrin e Madh, Turqit Skënderbeun, njerëz këta të së njëjtës racë, të të njëjtit gjak”;*²²

²⁰ Edhe pas një gjysmë shekulli (1835), piktori dhe udhëtari anglez

Martin Leak, në Himarë, i cili është përgjithësisht nga më të informuarit, ka vënë re të njëjtën gjë, kur thotë se greqishtja flitej nga burrat, ndërsa italishtja nga ata që kishin qenë jashtë, ndërsa gratë dinin pak e aspak gjuhë të tjera, veç shqipes, “Travels I 88).

III. FAKTE E HULUMTIME MBI LËVRIMIN E GJUHËS SHQIPE NË PERIU DHËN 1216 – 600 PAS KRISHTIT

3.1 Ky Kuvend me punimet dhe hulumtimet e tij gjuhësore do të sjellë kumtesa që të hedhin dritë mbi lidhjet e gjuhës shqipe me ato sllave, për të sjellë në vëmendje fakte që kërkojnë përgjigje si:

1. Pse ministri i parë i Arsimit të Serbisë Dositej Obradoviç, pohon se: gjuha e tyre është e thjeshtë dhe mund të mësohet fare lehtë, kurse me shkronjat tona mund të shkruhet, si të ishin bërë për të.

2. Pse një pjesë e gjuhëve, si latinishtja, gjermanishtja dhe thuajse pjesa më e madhe e gjuhëve të Ballkanit, kanë elementë të rëndësishëm të gjuhës shqipe, çka vërtetohet nga fakti se një pjesë e foljeve kryesore të shqipes gjenden në këto gjuhë.²¹

3. Pse pllaka e shkrimit Marsiliana d'Albegna, në një kopje e skicuar nga Sprenger-Bertoloni, tregon se alfabeti është shkruar me grafi që fillon nga e djathta, me shkronja që nuk i gjejmë në alfabetin grek, as në atë latin, por për shqiptimin e saj, duhet të kthehesh tek alfabeti tepër i lashtë ilir, i njohur si alfabeti glagolik që e përdorte edhe kisha sllave, ndërsa Kirili e Metodi, më 862 sipas urdhrit të perandorit bizantin Mihail, krijuan një alfabet të ri, të quajturin cirilik, në të cilin u zëvendësuan karakteret e vjetra, me karaktere të reja të greqishtes së lashtë.

4. Shkaqe pse në Bullgari, shkrimi me alfabet glagolik, pushoi së përdoruri pas shekullit 12-të. Në Kroaci vijoi të përdorej gjer në shekullin e 20-të. Përdorimi më i vjetër është i shek. të 8-të të e.s., kur Papa Ieronimi nga Dalmacia e përdori për shkrimin e librave kishtarë në gjuhën sllave.

5. Pse u ndalua dhe u luftua në shek. e 10-11-të, të e.s përdorimi i alfabetit glagolik në kishë, dhe u lejua përsëri të përdorej më 1248 nga Papa Innonzenz IV.

²¹ Stefan SCHUMACHER, te libri 'Historia e Shqiptarëve', fq. 50, botime përpjekja, v. 2012

²² Alphonse de LAMARTINE, (1790-1869), shkrimtar, poet, historian dhe Ministër i jashtëm i Francës shkruan këtë fjali në librin e tij 'Histoire de la Turquie'.

3.2 Por këto pyetje kërkojnë dhe thërasin për pyetje të tjera

1. A gjetën aty sllavët e jugut, pas ardhjes në Ballkan, shqiptarët, të cilët nën trysninë e tyre (sllavëve), u tërhoqën në jug dhe në vendet më malore, ku i hasim edhe sot, siç na e pohon profesori sllav Jovan Cvijiç?
2. A kanë qënë Ilirët banor të pjesës më të madhe të Jugosllavisë (së shekullit të kaluar), por më pas u shtynë drejt jugut prej pushtuesve sllav, pra, sllavët ishin pushtues, kurse ilirët autokton, siç pohon shkencëtari grek L. S. Stavrinos në studimet e tij? Ose siç pranon Dr. M. Panov se: *banorët vendas para ardhjes së sllavëve në Ballkan, janë ilirët...*, ku një pjesë e popullsisë vendase u vranë, të tjerët u shpërngulën dhe disa u përzien me sllavët?
3. A ka qënë raca antike Thrako-Iliriane, siç citon një doracak i Greqisë, *banorët e parë në rrethin midis Danubit dhe Aegean*, që u dëbuan, ose me shumë gjasa u përthithën nga emigracioni i madh i sllavëve, të cilët u mbajtën në intervale të ndryshme midis fundit të shek. III pas Krishtit dhe fillimit të shek. VI.²²

Tabelë fjalorth në midis gjuhëve pellazgjisht-shqip-sllavishte e vjetër

Pellazisht	Shqip	Sll. vj. kish	Par rrenjë prap	Pellazisht	Shqip	Sll. vj. kish	Par rrenjë prap
sun	çun	synu	syn u>y u	grop	grop	grobs	grob s
mes	në mes	mezda	mez s>z da	le	me lenë	lezati	le zati
dom	dhom	doma	da a	let	lehtë	letu	let u
ik	ikën	leik	le ik	stat	shtat	stati	stat i

Jo më kot, Lamartini gati gati 'bërtiste' se:

një pjesë e gjuhëve, si latinishtja, gjermanishtja dhe thuajse

²² Dor'cak i Greqisë, Vol. 1, fq. 75, v. 1918

pjesa më e madhe e gjuhëve të Ballkanit, kanë elementë të rëndësishëm të gjuhës shqipe, çka vërtetohet nga fakti se një pjesë e foljeve kryesore të shqipes gjenden në këto gjuhë.²³

IV. FAKTE E HULUMTIME MBI LËVRIMIN E GJUHËS SHQIPE NË PERIU DHËN 600 PAS KRISHTIT – 600 PARA KRISHTIT

Ky Kuvend me punimet dhe hulumtimet e tij gjuhësore do të sjellë kumtesa që të hedhin dritë mbi lidhjet e gjuhës shqipe me atë ilire, për të sjellë në vëmendje fakte që kërkojnë përgjigje:

1. Si mozaiku i Mesaplikut i shek. VI pas Krishtit që shërben si një artefakt kuptimplotë për shkrimin e gjuhës shqipe, që e kanë ruajtur sepse e interpretonin me bazë të gjuhës greke, se ndryshe do ta kishin shkatërruar si të tjerat.²⁶



2. Si vula në rrëzë të malit të Shpiragut, aty ku ngrihej qytetërimi ilir, ku spikat fjala MAL-DIMAL-emër i fisit ilir.²⁴

²³ Stefan SCHUMACHER, te libri 'Historia e Shqiptarëve', fq. 50, botime përpjekja, v. 2012 ²⁶ Mirënjohje Niko Stillos.

²⁴ Mirënjohje prof. Neritan Cekës).




Fig. – 8 Mozaiku i Mesaplikut i shek. VI p.e.s.


3. A flet dhe lexohet me anë të shqipes ky epitaf i shek. III p.e.r nga varri i djalit të Lykiskos, "Fëmija hyjnëron" (n'hare apo n'ajër)Ill, Yll, Yj, Yje,Yjnor,Hyjnor,



Vulë mbi tjegull me emrin e qytetit Dimal.

Fig. – 9 Vula mbi tjegull me emrin e qytetit Dimal.

a flet dhe lexohet shkrimi i kësaj pllake e quajtur shtylla e Lemnosit, me anë të shqipes?



Illirët formuan alfabetin latin dhe gjuhën latine si dhe vet' perandorinë latine (romake

Fig. – 10 Epitafi i shek. III p.e.s nga varri i djalit të Lykiskos.

hanibale), kurse 29 perandorë romakë, që nga perandori i parë, ishin me origjinë të drejtpërdrejt Iliriane.

Ky Kuvend me punimet dhe hulumtimet e tij gjuhësore do të sjellë kumtesa që të hedhin dritë mbi lidhjet e gjuhës shqipe me atë helene, për të sjellë në vëmendje fakte që kërkojnë përgjigje:

1.A ndodhet një civilizim më i hershëm nën pluhurin e civilizimeve helene, apo barbarizmave romake, serbe, bizantine dhe otomane?

